

## ON-OFF

### *Hyrje e shkurtër*

Sipas nje anekdote një abonent shkon në bibliotekë dhe kërkon një kopje të Kushtetutës së Francës – punonjësi i bibliotekës i përgjigjet se “Biblioteka jonë nuk mban periodikë”.

Batuta ngërthen një këndvështrim satirik anglo-amerikan që sheh Francën në kredencialet e saj demokratike të përqëndruara më shumë në modë dhe formë, sesa në substancë.

### *Disa statistika in extremis*

Për shkak të neneve procedurale dhe thelbësore, Kushtetuta Gjermane mund të quhet si kushtetute e rreptë (rigid), ndonëse deri më sot ajo është ndryshuar 52 here. Përafërsisht Kushtetuta Gjermane ka ndryshuar cdo katër vjet të ekzistencës së saj, ndërsa Kushtetuta e SHBA-ve ka pësuar vetëm 27 amendamente në dy shekuj jetë dhe vetëm 6 amendamente në kohën që përkon me jetëgjatësinë e Kushtetutës aktuale Gjermane. Në të vërtetë, refoma kushtetuese gjermane alternohet në vite të aktivizimit të plotë dhe vite të pozicionit qetësues. Kështu asnjë amendament nuk u miratua nga 1976 deri në 1983 dhe nga 1984 deri në 2000. Vetëm në vitet 1968-1972 u miratuan 16 amendamente. Shqyrtimi i këtyre numrave të con në një konkluzion interesant: amendamentet kushtetuese arritën pikun e tyre kur aktiviteti legjislativ gjithashtu ishte shumë intensiv. Nga 1990 përafërsisht është miratuar një amendament kushtetues për vit.

### *Ndryshimi formal dhe informal*

Kushtetutat janë tekste, por njëkohësisht dhe pashmangshërisht më shumë se tekste. Ashtu sikundër Kushtetuta në tekstin e saj përpunon varietete të praktikave politike, organeve shtetërore dhe procedurave, ligje organike dhe kufizime praktike, ashtu edhe kuptimi ynë për to - kuptimi ynë për konstitucionalizmin si ide teorike dhe praktike – është kushtëzues për interpretimin e saj.

Në të drejtën kushtetuese mënyra e interpretimit është gjithcka. Ky duhet të përbëjë një fakt që duhet ta mbajmë mirë parasysh kur shpesh i adresohemi atyre që i quajmë si “defekte të hartimit” ose “anomali”. Është e lehtë për studiuesit e shkencave politike dhe të tjerë jojuristë që të mënjanojnë nga teksti dhe të humbasin fokusin në kontestin e gjerë që përmenda.

Në Mbretërinë e Bashkuar, një nga traditat kushtetuese më të konsoliduara në glob që daton të paktën nga *Magna Carta* në 1215, e vetmja përpjekje për të hartuar një kushtetutë ishte dështim, dhe rruga e ngadashme e zhvillimit të zakoneve, praktikës, common law dhe ligjeve organike në mënyrë shumë adekuate mbushi

hapësirën që normalisht do të duhej të mbulohej nga një kushtetutë e shkruar. Tani, megjithëse shumë prej ligjeve kushtetuese janë të shkruar dhe në këto dhjetë vjet reforma të medha janë ndërmarrë në UK, është ende e fortë ekzistenca e konstitucionalizmit si një aspekt permanent i mjedisit politik dhe ligjor.

Sot në botë amendamenti formal i kushtetutës nuk është e vetmja formë e ndryshimit të saj. Mjetet alternative dhe po aq legjitime të ndryshimit të Kushtetutes janë: i) nepermjet interpretimit gjyqësor dhe ii) evoluimi i traditave/zakoneve të pashkruara politike (+ kultura kushtetuese). Sesi këto dy instrumenta influencojnë në një sistem të caktuar kushtetues diktojnë edhe nevojën e amendamenteve formale.

*Interpetimi gjyqësor* lidhet shumë interpretimin dinamik dhe krijues nga ana e gjykatave kushtetuese për kushtetutën.

*Ttraditat dhe zakonet kushtetuese.* Kjo metode eshte po aq legjitime dhe e e përdorur dhe konsiston në evoluimin e traditave/zakoneve politike në organet legjislative dhe ekzekutive. Në shume vende statusi i këtyre traditave është njohur dhe reflektuar në konceptin e një “zakoni“ ose “zakoni kushtetues”. Ato nuk krijohen nga gjykata, ato nuk miratohen apo vendosen, por evoluojnë me kohën duke reflektuar veprimet dhe perceptioet normative të aktorëve politikë.

*Kultura kushtetuese* me të cilën kuptohen se bashku norma kombëtare në interpretimin kushtetues (strikt ose fleksibël), metanormat e pashkruara që rregullojnë se në çfarë mase ndryshimi është konsideruar legjitim, vlera simbolike e tekstit kushtetues dhe dinamizmi ose konservatorizmi i aktorëve kushtetues (politikanë, gjykatës, profesorë, studentë, nëpunës civil etj) dhe faktorë të tjerë.

## **dhe NE ???!**

Ndryshimi formal i kushtetutës është absolutisht një e drejtë legjitime dhe e realizueshme. Por në këndvështrimin tim ndërhyrja formale kërkon edhe kontekstin e duhur. Kusht *sine qua non* në këtë ndërmarrje madhore është “mirëbësimi”, në rast se ai ekziston amendamenti kushtetues ka sukses, në rast se ai nuk ekziston amendamenti kushtetues nuk e ka jetën e gjatë.

Mbase një drejtim tjetër ku duhet të fokusojmë analizëm dhe përpjekjet reformatore është “habitati ku jeton Kushtetuta”. Ndaj edhe analiza e ndërhyrjes kushtetuese duhet të ngërthejë edhe një sërë faktorësh të tjerë, vecanërisht të zhvilluar në shoqëritë perëndimore. Përpos rolit të gjykatës kushtetuese në interpretimin e norms së shkruar, cilësisë së drejtësisë kushtetuese të dhënë prej saj (që ka qënë dhe mbetet debat i madh) mbase është me vend të shohim pak rolin e partive politike dhe të përfaqësimit të tyre në organet kushtetuese, aty ku kushtetuta e kërkon këtë gjë. Në fund të fundit vullneti politik është primar.

*(“political instructions” do të kërkonte një nëpunës civil në UK).* Ekspertiza teknike në këtë rast është po ashtu e vlefshme, por secila në vendin e saj.

Kushtetuta e Shqipërisë i ka dedikuar partive politike një rol kyc, ato nuk përmenden aty si organizime OJF-sh, por kanë karakterin e nje organi kushtetues dhe si të tilla kanë të drejta dhe detyrime kushtetuese. Statutet dhe aktiviteti i partive politike është pashmangshërisht subjekt i së drejtës publike dhe për pasojë edhe publiku ka interes legjitim për cilësinë e ofertës së partisë politike që kërkon përfaqësim në parlament.

Shqipëria është një vend ku lista e deputeteve ligjvënës, për pasojë edhe deputetëve kushtetutëbërës, miratohet dhe bëhet e njohur vetëm 5 minuta para mbarimit të afatit zyrtar për rregjistrim (unikale si praktikë). Shqipëria është vend ku ende nuk dihet si përzgjedhen kushtetutëbërësit/kushtetutëamenduesit? Cilat janë krierte që aplikohen në zgjedhjen e tyre? Sa respektohet në këtë përfaqësim statuti i partive politike në këtë aspekt të rëndësishëm dhe vendimtar të aktivitetit politik? Po transparenca ku është? Si është situata e financimit të partive politike? Cila është pjesa e dukshme dhe e padukshme dhe roli i instrumentave shtetërore, me interes publik për mbikëqyrjen e tyre - efektiv dhe jo iluziv? etj. etj

dhe pastaj të vijmë tek “ kultura kushtetuese” .....

..